


BULETINI



NR. 5 | KORRIK – SHTATOR 2019 |



Buletini Informues Cens 2020 shërben si pasqyrë e aktiviteteve kryesore që INSTAT ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë deri në përfundim të këtij projekti. Ai shpërndahe me frekuencë tremujore. Në numrin e pestë të buletinit paraqiten aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës Korrik-Shtator 2019 dhe çfarë pritet të ndodhë gjatë muajve në vijim.

CENSI I POPULLSISË DHE BANESAVE 2020

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) ka planifikuar të kryejë Cens-in e ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2020. Cens-i i Popullsisë dhe Banesave 2020 do të ndjekë metodën e numërimit të drejtpërdrejtë universale bazuar në operacionet në terren me plotësimin e pyetësorëve nga anketuesit, duke përdorur teknika të reja për mbledhjen e të dhënave.

KONTAKT:

NR. JESHIL 0800 22 44

PËRMBAJTJA

Aktivitetet e CENS 2020, Korrik-Gusht-Shtator 2019

- Konferenca Hapëse për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020
- Takimi i parë i Komitetit të Lartë Drejtues (SCM)
- Finalizimi i materialeve informuese
- Aplikacioni CAPI për mbledhjen e të dhënave
- Testimi i aplikacionit CAPI
- Pre-test i pyetësorit në aplikacionin CAPI
- Rekrutohet stafi për Cens 2020
- Përditësimi i zonave pilot për Cens 2020
- Manualët për anketuesit e terreni
- Aktivitetet e parashikuara për periudhën Tetor – Dhjetor 2019



Konferenca Hapëse për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020



Në datë 20 Shtator 2019, INSTAT në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, organizoi Konferencën Hapëse për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020. Qëllimi i kësaj konference ishte informimi i publikut dhe rritja e ndërgjegjësimit mbi Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020, si dhe lancimi i Pilotit të Censit, i cili do të zhvillohet në periudhën Tetor-Nëntor 2019. Në këtë konferencë morën pjesë të gjithë aktorët e përfshirë në implementimin e projektit.

[Konferenca Hapëse për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020](#)

Takimi i parë i Komitetit të Lartë Drejtues (SCM)

Në datë 29 Gusht 2019 u organizua takimi i parë i Komitetit të Lartë Drejtues (SCM). Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i ecurisë së aktiviteteve të Cens-it. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe përfaqësues nga donatorë lidhur me Projektin Cens 2020.

Në datë 9 Gusht 2019 u përgatit Inception Report nga Asistenca Teknike. Ky raport i fillimit ka për qëllim vlerësimin e situatës aktuale të INSTAT, dhe adaptimin e aktiviteteve të propozuara me nevojat aktuale të INSTAT. Ky material përmban aktivitete konkrete që janë planifikuar të realizohen gjatë implementimit të CENS 2020. Pas aprovimit të tij nga Këshilli i Lartë Drejtues ky dokument do të jetë referenca kryesore për projektin dhe implementimin e aktiviteteve.

Finalizimi i materialeve informuese



Gjatë periudhës Korrik – Shtator 2019, INSTAT ka përgatitur dhe finalizuar materialet informuese për pilotin e Censit.

Në këtë kuadër janë përgatitur fletëpalosjet, bexhet, çantat dhe distiktivët me logot e INSTAT dhe Cens 2020, të cilat do të shpërndahen në zonat e pilotit.

Gjithashtu, është përgatitur prezantimi për trajnimin e supervisorëve, kontrollorëve, anketuesve mbi Kodin e sjelljes, konfidencialitetin statistikor dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Aplikacioni CAPI për mbledhjen e të dhënave

Gjatë periudhës Korrik– Shtator 2019, INSTAT në bashkëpunim me ekspertët ad-hoc të IPA MB 2015, zhvilloi aplikacionin CAPI për mbledhjen e të dhënave me anë të platformës Survey Solution. Survey Solution është një platformë e ndërtuar nga Banka Botërore për të zhvilluar aplikacione për mbledhjen e të dhënave në mënyrë elektronike.

Të njëjtën platformë përdor dhe aplikacioni i monitorimit për kontrollorin që u zhvillua gjatë muajit Shtator. Ky aplikacion përbëhet nga disa forma raportimi:

- Raporti nëpërmjet të cilëve kontrollohet progresi i anketuesve
- Raporti që lejon analizimin e cilësisë së intervistave të kryera nga anketuesit. Nëse intervista e kryer është plotësuar në mënyrë korrekte, kontrollori e aprovon. Në të kundërt, kontrollori e kthen intervistën tek anketuesi për korrigjimet e nevojshme
- Raporti në lidhje me gjatësinë e intervistave
- Raporti i numrit të intervistave sipas ditëve.

Testimi i aplikacionit CAPI

Gjatë muajit Shtator u zhvillua Pre-test. Një ndër objektivat kryesore të këtij testi ishte evidentimi i përmirësimeve në aplikacione dhe shmangia e gabimeve në mbledhjen e të dhënave që mund të sjellin vështirësi në proceset e mëtejshme të analizimit dhe përpunimit të të dhënave.

Aplikacioni CAPI për anketuesit u testua në lidhje me funksionalitetin (mbledhjen e të dhënave, kontrollet logjike), përdorimin (navigimi dhe përmbajtja), paraqitjen (p.sh. të sigurohemi që mesazhet e gabimeve shfaqen siç duhet), me performancën (si vepron aplikacioni në rast kur tableti apo vetë aplikacioni bën crash), me sigurinë (identifikimin e anketuesve). Nga testimi u evidentuan mangësi, të cilat u reflektuan në versionet e mëtejshme.

Pre-test i pyetësorit në aplikacionin CAPI

Gjatë periudhës Korrik-Shtator 2019, janë ndjekur misionet lidhur me zhvillimin e aplikacionit të pyetësorit si dhe janë testuar në mënyrë të vazhdueshme versionet e përditësuara të aplikacionit për të siguruar një ecuri logjike të tij. Në këtë kuadër është ndjekur misioni i Editing Rules për rishikimin e aplikacionit të mbledhjes së të dhënave dhe reflektimin e ndryshimeve të fundit nëse do të ishte e nevojshme.

Gjithashtu, është ndjekur misioni me ekspertin e Tabulimeve, ku është përgatitur drafti i parë i Planit të Tabulimeve.

Rekrutohet stafi i nevojshëm për Censin 2020

Në kuadër të fazës parapërgatitore të projektit Cens 2020, për periudhën Korrik- Shtator 2019, janë punësuar staf me kontratë, si Anketues, Kontrollorë, Supervizorë, Specialist Rrjeti IT, Specialist Programistë IT dhe Specialist i Burimeve Njerëzore. Këto pozicione pune u publikuan edhe në portalin Duapunë.com. Gjatë muajit Gusht 2019, janë mbledhur kandidaturat dhe është kryer përzgjedhja e stafit sipas kriterëve të kërkuara, të cilët gjatë muajit Shtator 2019 u trajnuan për Pre-testin në kuadër të Cens 2020.

Përditësimi i zonave pilot për Cens 2020

Gjatë muajve Korrik - Shtator 2019 në zbatim të planit të punës dhe përgatitjeve për Cens 2020, ka përfunduar përditësimi i zonave pilot (100%), kontrolli i tyre në terren, kontrolli në zyrë, pastrimi i të dhënave dhe përgatitja për të qenë të gatshme për t'u kaluar në tablet për anketuesit e Censit pilot.

Puna ka vijuar dhe me anketën e përditësimit të hartave, ku aktualisht është përditësuar rreth 73% e të gjithë zonave të Censit, duke qenë brenda planit dhe parashikimeve. Disa prej përditësimeve në terren të bashkive pilot, janë në procesin e kontrollit në zyrë nga operatorët GIS.

Manualet për anketuesit e terrenit

Në kuadër të Censit pilot, gjatë periudhës Korrik - Shtator 2019 janë përgatitur manualët për anketuesit e terrenit si dhe për kontrollorët GIS, të cilët do të angazhohen gjatë pilotit me përditësimin e mëtejshëm të hartave dhe dhënien ndihmë anketuesve të terrenit për orientimin në zonat e tyre të punës.

Gjithashtu, janë përgatitur prezantimet për trajnimin e supervisorëve, kontrollorëve, anketuesve dhe ndihmës-specialistëve GIS.

Aktivitetet e parashikuara për periudhën Tetor – Dhjetor 2019

Gjatë 3 mujorit të katërt 2019, do të zhvillohen aktivitetet e mëposhtme:

- Fillimi i Pilotit të Censit. Piloti i Censit do të zhvillohet më 21 Tetor 2019 dhe do të kryhet në 10 bashki të zgjedhura si zona specifike, të cilat janë Durrësi, Himara, Kolonja, Malësia e Madhe, Kukësi, Maliqi, Pusteci, Shkodra, Tirana dhe Vlora.
- Trajnimi i supervisorëve dhe anketuesve në kuadër të zhvillimit të Pilotit të Censit dhe pajisja e tyre me bazën materiale.
- Zbatimi i aktiviteteve në mbështetje të fushatës së komunikimit, e cila do të përfshijë organizimin e tryezave të rrumbullakëta, organizimin e intervistave në TV dhe Radio, informimin e përdoruesve nëpërmjet rrjeteve sociale, shpërndarjen e fletëpalosjeve informuese, çantave dhe distiktivëve me logon e INSTAT dhe Cens.
- Në ambientet e INSTAT do të zhvillohet takimi me misionin e katërt të monitorimit.